



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**  
**ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT**  
**NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE**

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 6 të Rregullores Nr.01/2017 për Marrëdhënie Pune me datën 05.12. 2017, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

**KONKURS**  
**për plotësimin e vendeve të lira të punës**

**I. Pozita:** Auditor  
**Kodi:** A/ZKA/23-12/17  
**Grada:** Përcaktohet me akt të veçantë  
**Numri i pozitave:** Dy (2)  
**Kohëzgjatja:** Me kohë të pacaktuar  
**Vendi:** Prishtinë

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1. Në mënyrë efektive koordinon punën e auditimit me Udhëheqësin e ekipit dhe ofron mbështetje në ekip si ekspert i auditimit;
2. Përfundimi i njohurive të plota rreth institucioneve të audituara dhe kuptueshmëri të plotë të çështjeve, prioritetëve dhe rrethit që i ballafaqojnë ato (pako për njohjen e punës);
3. Ndihmon UEA-në në planifikim të auditimit, duke përfshirë programet dhe metodat e auditimit;
4. Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga UE dhe Udhëheqësi i Departamentit;
5. Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
6. Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës për çdo fazë të auditimit dhe dorezimi i tyre tek UEA;
7. Ofron përkrahje profesionale duke kryer procedura analitike të të dhënave financiare dhe jo financiare;
8. Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike dhe gjykimet për të arritur në konkluzione të qëndrueshme në bazë të dëshmive të mbledhura;
9. Përgatitja e LP (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar;
10. Kryen detyra tjera të ngarkuara nga mbikëqyrësi.

### **Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Diplomë fakulteti;
- Së paku 7 vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet apo financa;
- Certifikim në njërin nga skemat e certifikimit për kontabilist, auditor apo auditor i brendshëm.
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale, aftësi të mira komunikimi verbal dhe në të shkruar si dhe njohuri të mirë rreth gjuhës angleze.

### **Informata të përgjithshme për kandidatë:**

Përcaktimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

### **Procedura e konkurrimit:**

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:** Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese, si dhe dëshmitë/dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e punës të kërkuar sipas konkursit.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: <http://www.zka-rks.org/>

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org), nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në zyrën e Divizionit për Burime Njerëzore të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është dita e mërkurë, 20 dhjetor 2017, ora 16.00.

### **Shënim:**

Kërkesat e dërguara pas afatit të përcaktuar me konkurs nuk do të shqyrtohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit eventual të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.